



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
PROKURORIA THEMELORE / OSNOVNO TUŽILAŠTVO / BASIC PROSECUTION
PRIZREN - PRIZREN

AD.nr. 1/25
Dt. 10.02.2025
Prizren

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, duke vendosur lidhur me çështjen disiplinore të iniciuar pas pranimi të ankesës së qytetarit [REDAKTUAR], nga fshati [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], me banim në [REDAKTUAR], rruga "[REDAKTUAR]", nr. [REDAKTUAR], kundër prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, [REDAKTUAR], në bazë të nenit 9 par.1 pika 1.5 dhe par.6 të Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 par.3 nënpar.3.1 të Rregullores nr. 05.2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, nxjerr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e qytetarit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], kundër prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], sepse çështja në fjalë konsiderohet e trajtuar më parë dhe nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore, nga neni 6 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Më datë 04.02.2025, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, ka pranuar një ankesë nga qytetari [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], ndaj prokurorit të Prokurorisë Themelore të Prizrenit nga Departamenti i Përgjithshëm [REDAKTUAR] [REDAKTUAR].

Dyshimet e para për shkelje disiplinore:

Dyshimet e para sipas ankuesit të parashtruara në ankese të cilën e ka titulluar "ankesë dhe kërkesë" është bërë për Autoritetin Kompetent me pretendimin se prokurori [REDACTED] [REDACTED], në rastin [REDACTED], i ka bërë padrejtësi të njëjtit duke i bërë shkelje të qëllim të një rast ku pretendon se ishte sulmuar nga një zyrtar policor.

Vlen të theksohet se ankuesi, të njëjtat pretendime në parashtrësë i ka edhe ndaj prokurorit [REDACTED] [REDACTED], i cili tani është me punë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, për të cilin konform dispozitave të nenit 9 par.2 të Ligjit Nr. 06/L – 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, njëkohësisht është njoftuar Kryeprokurori i PSRK [REDACTED] [REDACTED], si autoritet kompetent për të trajtuar ankesën, në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pasi që kemi pranuar këtë shkresë të njëjtën e kemi regjistruar në regjistrin e procedurave disiplinore dhe ka marrë numrin AD.nr.1/2025, për rastin në fjalë sipas procedurave është njoftuar Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkatësisht kryesuesi i KPK-së, [REDACTED] [REDACTED].

Veprimet e Autoritetit Kompetent:

Më datë 06.02.2025, Kryeprokurori ka kërkuar deklaratë lidhur me pretendimet në fjalë nga prokurori [REDACTED] [REDACTED].

Më datë 06.02.2025, kam pranuar deklaratën me shkrim nga prokurori [REDACTED] [REDACTED].

Të gjeturat e rastit disiplinor:

Paraqitësi [REDACTED] [REDACTED], me datë 09.01.2020 ka paraqitur në Prokurorinë Themelore në Prizren, kallëzimin penal, kundër të paraqiturve [REDACTED] [REDACTED] dhe [REDACTED] [REDACTED], -zyrtar policor në NJHRKRR në Prizren, nën dyshimin e arsyeshëm se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par. (1) të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës.

Më datë 09.01.2020, në Departamentin e Përgjithshëm, është pranuar kallëzimi penal i lartcekur ndaj të dyshuarve të lartcekur në drejtim të veprës penale: Keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike nga neni 195 par. (1) të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës.

Pas pranimi të kallëzimit penal është bërë shqyrtimi dhe vlerësimi i plotë i tij, si dhe janë analizuar provat të cilat i janë bashkangjitur, me qëllim që të adresohet në mënyrë të drejtë kjo çështje penale.

Prokurori i çështjes ka ndërmarrë veprime hetimore në bashkëpunim me IPK-në, janë marrë në pyetje të dyshuarit dhe i dëmtuari, janë siguruar edhe prova dhe dëshmi të tjera materiale.

Nga raporti lidhur me shqyrtimin e ankesës së qytetarit [REDACTED], IPK-ja me nr. të referencës [REDACTED], të datës 05.11.2019, pas procesit të trajtimit të ankesës hetuesi i DTA-së ka ardhur në përfundim se nuk ka elemente të veprës penale. Bazuar në rezultatet e procesit të shqyrtimit të ankesës, kanë vlerësuar se lënda duhet të procedohet për trajtim të mëtejshëm në Drejtorinë e Hetimeve të Brendshme dhe Verifikimin e së kaluarës në Policinë e Kosovës (DHBVK), për shkelje eventuale diskredituese.

Nga raporti përfundimtar i hetimeve me rekomandim lidhur me lëndën disiplinore për zyrtarët Policor [REDACTED], dhe [REDACTED], i njësisë së hetimeve të brendshme dhe verifikimit të kaluarës - zyra në Prizren me nr. të referencës [REDACTED], të datës 17.12.2019, shihet se nga të gjeturat nga ky hetim paraqitja e zyrtarëve policor nga [REDACTED], nuk ka mund të argumentohet, dhe njëherit është *rekomanduar që edhe lënda disiplinore të mbyllet si e pa argumentuar*.

Nga vendimi Njësisë së hetimeve të brendshme dhe verifikimit të së kaluarës - zyra në Prizren me nr. të referencës [REDACTED], të datës 06.02.2020, shihet se është pushuar procedura disiplinore ndaj zyrtarëve të policisë: [REDACTED], dhe [REDACTED], *për shkak se gjatë hetimeve nuk janë gjetur elemente të shkeljeve disiplinore*.

Sa i përket raporteve mjekësor, është e vërtetë që [REDACTED], është vizituar ditën kritike në QKMF në Prizren për shkak të ankesave në dhimbje të regjionit torakal, nuk është provuar se të njëjtat lëndime mund të jenë shkaktuar nga zyrtarët policor.

Prokurori i çështjes ka analizuar provat materiale dhe personale: raportin lidhur me shqyrtimin e ankesës së qytetarit [REDACTED], IPK-ja me nr. të referencës [REDACTED], të datës 05.11.2019, raporti përfundimtar i hetimeve me rekomandim lidhur me lëndën disiplinore për zyrtarët Policor [REDACTED] dhe [REDACTED], i njësisë së hetimeve të brendshme dhe verifikimit të kaluarës-zyra në Prizren me nr. të referencës [REDACTED], të datës 17.12.2019, vendimin Njësisë së hetimeve të brendshme dhe verifikimit të kaluarës-zyra në Prizren me nr. të referencës [REDACTED], të datës 06.02.2020, si dhe deklaratat e zyrtarëve policor [REDACTED], dhe deklarimin në polici dhe në Prokurori të qytetarit [REDACTED].

Prokurori pas shqyrtimit dhe realizimit të gjitha provave personale dhe materiale, ka marrë aktvendim për hudhjen e kallëzimit penal të parashtresit [REDACTED], dhe të njëjtin brenda afatit ligjor, pra më datë 02.02.2023, e ka njoftuar dhe i ka dërguar një kopje të aktvendimit për hudhjen e kallëzimit penal, [REDACTED], të datës 02.02.2023 dhe i njëjti aktvendim është pranuar nga [REDACTED], - familjare e paraqitësit [REDACTED], datë 02.02.2023, ku e njëjta vërtetohet edhe nga fletë kthesa.


Konkluzioni:

Kryeprokurori si autoritet kompetent, nga të lartcekurat, pas vlerësimit dhe elaborimit në detaje si më lartë, si dhe pas analizimit të kësaj çështjeje disiplinore, nga deklarata e prokurorit të lartcekur, në veçanti nga shkresat e lëndës, e po ashtu, nga informata e marrë ndërkohë se për të njëjtën çështje është vendosur edhe njëherë më parë nga ish kryeprokurori [REDACTED], të cilin rast me vendimin [REDACTED], datës 28.02.2023, e ka refuzuar edhe në atë kohë, andaj,

kryeprokurori ka konstatuar dhe vendosur se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga shkeljet disiplinore, nga neni 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore Të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, pasi që në bazë të shkresave të kësaj lënde konstatohet se prokurori i rastit i ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme ligjore konform dispozitave ligjore në fuqi dhe të gjitha veprimet e prokurorit kanë qenë profesionale dhe ligjore dhe në kuadër të fushë veprimtarisë funksionale dhe profesionale të prokurorit të shtetit, duke mos rënë ndesh për asnjë moment me kodin etik dhe sjelljen e pahijshme të prokurorit të shtetit. Për më tepër kjo ankesë konsiderohet si e trajtuar ngase edhe më parë është vendosur për të njëjtën çështje nga ish kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prizrenit.

...

Me sa u cek më lart u vendos si në dispozitiv të vendimit.



T'i dorëzohet:

- Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- [Redacted]
- Arkivës.